



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:277564

Datë: 13.03.2020

Numri i dokumentit: 00899674

P.nr. 1093/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit L R për shkak se ka kryer veprën penale dhune ne familje nga neni 248 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PP/II.nr.1412/19, të dt. 22.11.2019 pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar të datës, 24.02.2020, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Muharrem Bajraktari, te pandehurit Leonard R, mbrojtësit te te pandehurit av. Filloreta Hoxha sipas detyrës zyrtare, te dëmtuarës B M, mbrojtësit te viktimave Demë Hasanaj, në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht ndërsa me dt 13.03.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

L R, i biri i K dhe nënës V e gjinisë SH, i lindur me ..., në O .., me vendbanim ne P , rruga B banesat e R , hyrja .., kati i .., nr. .., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr....., ka te kryer shkollën e mesme, i papune, i pamartuar, i gjendjes se mesme ekonomike, posedon tel.nr., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

- Me par e gjere me dt. 19.06.2019, ne vazhdimësi ne P ne rr.”..” brenda marrëdhënie familjare , me qellim te cenimit te dinjitetit ushtron keqtrajtim psikologjik ndaj viktimës se ndjeshme B M – me te cilen ka bashkëjetuar dhe me te njëjtën ka një djalë, ne atë mënyrë qe i pandehuri përmes porosive telefonike i drejtohet viktimës me fjale kërcënuese si “ju kalli krejt juve, shtëpinë kam me jua kall, keni me mbete pa shtëpi , ka ardhur fundi me i bo ato tmijat, kur drite prej meje skeni me pa” e shume fjale tjera kërcënuese dhe ofenduese, e po ashtu i pandehuri me date 19.06.2019 shkon tek shtëpia e babait te dëmtuarës ne vendin e lartcekur duke kërkuar qe te takohet me te njëjtën e cila nuk pranon qe et takohen, e pasi i njëjti takohet me djalin e tij, largohet nga aty, me çka tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë,

- Me çka ka kryer veprë penale dhunë në familje nga neni 248 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së .

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 39, 40, 43, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 248 par. 2 e lidhur me par. 1 te KPRK-së, dhe nenit 365 të KPP-së të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË DHE DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit të lartcekur i përcaktohet

- **I.** Dënimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim obligohet që ta paguajë më se largu në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit dhe
- **II.** Dënim me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohen në rast se i pandehuri brenda periudhës një (1) vjeçare nuk kryen ndonjë veprë të re penale.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë të cekur si më lartë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti shndërrohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet në pagimin te shpenzimeve gjyqësorë ne shumen prej 100 (njëqind) euro dhe te paushallit gjyqësor ne shumen prej 20 (dyzet) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, B M nga Peja rr. "Fatmir Uka" nr. 38, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka ngrit aktakuzë Pejë, PP/II.nr.1412/19, të dt. 22.11.2019, kundër të pandehurit, L R i akuzuar për veprën penale dhunë ne familje nga neni 248 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK -së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 24.02.2020, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar ku prezent kanë qenë prokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i te pandehurit, e dëmtuara dhe mbrojtësi i viktimave.

Gjykata konform dispozitave te nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta.

Pas leximit të aktakuzës, nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia të pandehurit që të deklarohet

për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ndihet i penduar, premton se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, i kërkon falje palës së dëmtuar, deklaron se i ka të qarta pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë dhe se vullnetarisht e bënë pranimin e fajësisë pa kurrfarë presioni.

Mbrojtësja e të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaron se i mbrojturi i saj gjate gjithë procedurave ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe kërkon nga gjykata që t'ia pranojnë fajësinë dhe këtë rrethanë ta vlerësojnë si rrethane lehtësuese, për vet faktin se nga koha e ngjarjes kritikë ai ka shprehur pendës e për çfarë ka ndodhur dhe i ka premtuar gjykatës që nuk do të përsërisë me faktin se i njëjti kujdeset për nënën për nënën e tij e cila është e sëmurë nga kanceri është i moshës së re, i gjendjes së vështirë ekonomike, i papunë dhe me rastin e vendosjes mbi dënim kërkon nga gjykata që t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë e mundësisht dënim me gjobë.

Mbrojtësja e viktimave lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që ky pranim ka mbështetje edhe në provat materiale të cilat janë propozuar në aktakuze, gjithashtu deklaron se pas konsultimeve me viktimën kërkon kompensimin e dëmit.

E dëmtuara deklaron se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe e parashton kërkesën pasurore juridike të cilën do ta realizoj në procedurë civile.

Prokurori i Shtetit, është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykes, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti i dërguar gjykatës me dt.10.10.2019, raporti i policit Zeqir Aliu i dt 19.06.2019, raporti i policit Rasim Podrimqaku i dt. 14.02.2019, deklaratat e ete dëmtuarës të dhëna në polici me dt. 14.02.2019, 10.04.2019 dhe 19.06.2019, deklarata e dëshmitareve B M, A M të dhëna në polici në dt. 19.06.2019,, porosit telefonike, deklarata e të pandehurit e dhënë në prokurori me date 07.11.2019, si dhe shkresat tjera, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me faktet e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit L R, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale se ka kryer veprën penale dhune në familje nga neni 248 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë, sinqeritetin deklarues, pendimin për veprën e kryer, premtimin se nuk do të kryej vepra tjera penale, kërkim falje palës se dëmtuar, ndërsa rrethana rënduese gjeti faktin se i njëjti edhe me parë ka qenë i dënuar për një veprë tjetër penale të posedimit të narkotiku.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nënpar. 2.6 të KPPRK-se, gjykata ka përcaktuar për të shpenzimeve gjyqësore në shumën prej 100 (njëqind) euro dhe të paushallit gjyqësor në shumën prej 20 (dyzet) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.1093/19 dt. 13.03.2020**

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

GJYQTARI
Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate